



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.09, datë 30.07.2024

PËR

MIRATIMIN ME KUSHT TË KËRKESËS PËR LEJE “KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË (NË RASTIN E UJËRAVE TË RRJEDHSHËM) NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR ≤ 5 TON/VIT, ≤ 5 L/SEK”, TË SUBJEKTIT “ARDIAN BALIJAJ”.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

VENDOSI:

1. Miratimin me kushtin e vendosur në pikën 3 (tre) të këtij vendimi, të kërkesës për leje “Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për ≤ 5 ton/vit, ≤ 5 l/sek”, të subjektit “ARDIAN BALIJAJ”, me vendndodhje: Fshati Kurt, Njësia Administrative Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Gurra e Bishkazit

Vendndodhja e burimit ujqor (KRGJSH):

- X= 464384
- Y= 4674766
- Z= 350 m.m.n.d

Prurja mesatare vjetore: Q=10 l/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q= 4.9 l/sek

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për akuakulturë (rritje intensive e peshqve, troftë).

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

- X= 464376
- Y= 4674796
- Z=345 m.m.n.d

Vëllimi i rrjedhës së kthyer: Q= 4.7 l/sek

3. Kjo leje jepet me kushtin e lidhjes së kontratës së ushtrimit të aktivitetit me ministrinë përgjegjëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e akuakulturës.

4. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

